



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2014/2015

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon të përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Shiko grafikun i cili tregon rezultatet e një anketa dhe zgjidhi detyrat 1, 2 dhe 3.



1. Me çfarë ka të bëjë anketa nga grafiku?

1 pikë

2. Sa nxënës janë përgjigjur se dëshirojnë që më tepër kohë në mësimdhënie t’i kushtohet këtij pasionit?

1 pikë

3. Lidhur me këtë çështje 2,79% të nxënësve:

1. janë deklaruar se nuk dinë
2. nuk janë deklaruar fare
3. nuk janë dakord me këtë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

Lexo me kujdes fragmentin nga libri për fëmijët “Portokalli fluturues” i Johan Galtungut dhe përgjigju nga pyetja 4 deri në pyetjen 14.

Emri im është Portokall. Po, ky jam unë. Unë jam një portokall. Ndoshta ti mendon se jam portokalli yt? Apo portokalli i shokut tënd. Apo portokalli i juaj. Nuk ka rëndësi. Unë qëndroj lart në pemë. Mëma – Pemë më ushqen. Unë rritem me ujë, ajër dhe diell. Të gjitha m’i siguron Mëma - Pemë. Vetë Mëma - Pemë ushqehet nga Mëma - Tokë. Por unë nuk jam vetëm. Me qindra e qindra portokall të tjerë qëndrojnë të varur në pemë dhe ushqehen e rriten si unë. “Është bukur”- thonë të gjithë.

Mos u habitni! ne portokallinjtë, mund të flasim me njeri-tjetrin. Kuptohet, jo si njerëzit, që flasin gjithë kohën. Unë mund të flas jo vetëm me portokallinjtë që kam pranë, por edhe me ata që janë larg. Unë mund të flas me portokallinjtë të tjerë, të cilët janë oqeanë larg, që rriten në vende ku jetojnë bizonë të mëdhenj të zinj, njerëz me ngjyrë e ku bie kaq shumë shi, sa Mëma - Pemë pothuaj përmbysen e shkulet nga Mëma – Tokë. Një ditë ndodhi diçka shumë e trishtuar. Një portokall ra në tokë. Aty pranë kaluan dy djem të vegjël. Ata ishin vetëm budallenj dhe filluan të grindeshin.

“E pashë unë i pari”- bërtiste njëri.

“E dua unë”,- bërtiste tjetri.

Kështu filluan luftën, se kush do ta merrte portokallin. Njërit i doli gjak nga hunda. Tjetri u rrëzua. Ku? Tamam mbi portokallin që qëndronte në tokë e që dëshironte kaq shumë t’i bënte të lumtur. Portokalli u shtyp, u çka dhe gjithë lëngu kulloi në tokë. Djali që ishte më i fortë, mori portokallin. Kjo ngjan me atë, që kur grinden dy vajza ato qajnë të dyja. Vajza që derdh më shumë lot, fiton. I bie që ajo të marr portokallin.

Mos ëndërro budallallëqe të tilla, sesi mund të luftosh për ta pasur të gjithë portokallin për vete. Përpiku të gjeshtë mënyra sesi mund ta ndash portokallin me miqtë e tu, me të tjerët. Edhe të rriturit mund të mësojnë të ëndërrojnë të bëjnë gjëra të bukura. Ka gjithmonë një portokall – mundësi.

4. Cili është mesazhi më i mundshëm i kësaj pjese të shkëputur?

1. Njerëzit janë të pandjeshëm ndërmjet veti
2. Njerëzit gjithmonë grinden ndërmjet veti
3. Njerëzit jetojnë të ndarë në mes veti
4. Njeriu gjen gjithmonë një mundësi

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

5. Fusha leksikore e fjalës portokall është:

1 pikë

6. Në kolonën e zbrazët të figurave letrare shkruaj figurën letrare që paraqet pjesa e zgjedhur.

Nr.	Pjesa e zgjedhur	Është figurë letrare:
1	Të mëdhenj	
2	Portokall-mundësi	
3	Portokalli dëshironte t'i bënte të lumtur	
4	Rritën si unë	
5	Mëmë - Pemë	

5 pikë

7. Çfarë emrit është emri portokall?

1 pikë

8. Arsyeja që portokalli këshillon, qëndron në:

1. Bindjen se bota mund të ndryshojë
2. Dëshirën për të ndryshuar botën
3. Funksionin që ai ka si portokall
4. Pozicionin nga i cili sheh gjithçka

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

9. Cili është detaji që e bën portokallin të dashur si mikun tuaj?

1 pikë

10. Çfarë është lidhëza “dhe” në fjalinë “Portokalli u shtyp, u ça dhe gjithë lëngu kulloi në tokë”?

1. Bashkërenditëse shtuese
2. Bashkërenditëse veçuese
3. Nënrenditëse kohore
4. Nënrenditëse vendore

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

11. A) Folja në fjalinë: “Portokalli e donte botën” është folje:

1. jokalimtare
2. kalimtare

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

B) Kryepersonazhit të këtij fragmenti dhe kryefjalës së fjalisë nën A) vëri një mbiemër cilësor _____

2 pikë

12. Kush e mori portokallin?

1 pikë

13. Zgjeroni grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit.

A) Miqtë e tu: _____

B) Qëndrojnë lart: _____

2 pikë

14. Cila është rrënja e fjalës tek fjala njerëzit?

1. njeri
2. njeriu
3. njerëzit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

15. Cila nga fjalitë e mëposhtme është nxitëse?

1. Artian ma jep dorën!
2. Çfarë po thotë Rinori?
3. Dashamiri këndon bukur.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

16. Fjalisë së mëposhtme gjej kryefjalën dhe trego se me çka është shprehur kjo kryefjalë. Shkruaj rasën, numrin ose vetën.

Ai u vonua pak më shumë se zakonisht

2 pikë

17. Fjalët e mëposhtme shndërroji në trajtën e shquar.

Thnegël _____

I sotëm _____

I cekët _____

3 pikë

18. Në fjalët e mëposhtme trego se në cilën rrokje bie theksi i fjalës:

Robër _____

Vatër _____

Pasqyrë _____

3 pikë

- 19.** Për ta prerë biletën mujore të udhëtimit falas në trafikun urban, Blerim Daija duhet ta dorëzojë vërtetimin se është nxënës i rregullt i SHF “Gjergj Kastrioti – Skënderbeu”, komuna e Tivarit. Shkruani me kujdes të dhënat e tij në vendet e parapara.

VËRTETIM

Me këtë vërtetohet se _____
(emri dhe mbiemri i nxënësit)

I biri i/e bija e _____ i lindur/e lindur në vitin _____ në
(emri i babait) (komuna)

_____, nxënës/e i/e rregullt i/e klasës së _____
(shteti)

_____ në _____
(emri i shkollës) (vendi)

Ky vërtetim lëshohet me qëllim të rregullimit të të drejtës në _____
dhe nuk mund të përdoret me qëllime tjera.

Data _____ 20 _____

Sekretari i shkollës

(Vendi i vulës)

4 pikë

- 20.** Shkruaje një hartim prej 80 deri në 100 fjalë, në të cilin do të përshkruash profesionin tënd të preferuar. Gjatë shkrimit të hartimit përdori figurat stilistike të cilat do t'i kontribuojnë paraqitjes më të figurshme dhe bindëse të temës së dhënë; hartimin formoje si një tërësi të rrumbullakuar mirë (me hyrje, zhvillim dhe përfundim). Titulloje hartimin.

Kij kujdes për rregullat e drejtshkrimit dhe ato gramatikore. Shkruaj qartë dhe respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/- 10% (vlerësohet ai hartim që ka prej 72 deri 110 fjalë; nëse hartimi ka më pak se 72 fjalë, NUK DO TË LEXOHEJ, ndërsa pas fjalës së 110-të leximi NDËRPRITET).

Kërkesat për shkrimin e hartimit me temën PROFESIONI IM I PREFERUAR

Shkruaj për:

- profesionin, rëndësinë dhe rolin e tij në përgjithësi (jepe mendimin tënd)
- profesionin e preferuar, ku bën pjesë ai, sa është kreativ, human...
- punën me të cilën merret ai profesion
- simpatitë që ke ndaj profesionit tënd të preferuar
- ndonjë mendim apo vlerësim për profesionin që pëlqen ti, çfarë e bën atë të veçantë

18 pikë	
---------	--

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2015